



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
REKTORI

Nr. 318 prot

Korçë, më 12 / 02 / 2021

UDHËZIM

Nr. 77, datë 12.02.2021

PËR

ZHVILLIMIN E PROVIMEVE

SEZONI I DIMRIT, VITI AKADEMIK 2020-2021

Bazuar në propozimet e ardhura nga njësitë kryesore, kërkesat e vazhdueshme të paraqitura nga studentët, si dhe në bazë të shkresës Nr. 749/25 prot, datë 11.2.2021 nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "*Mbi zhvillimin e disa prej provimeve të lëndëve specifike në auditor*", nga diskutimi me Rektoratin e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë,

UDHËZOJ:

1. Provimet në sezonin e dimrit për vitin akademik 2020-2021, në Universitetin "Fan S. Noli" zhvillohen të kombinuara, në auditor ose online. Provimi zhvillohet në auditor në rastet kur provimi i lëndës është i pamundur të zhvillohet online, për arsye të specifikave të lëndës, sipas vlerësimit të vetë njësisë.
2. Provimet në këtë sezon zhvillohen në përputhje të plotë me përcaktimet e Rregullores së organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore të Universitetit "Fan S. Noli", si dhe në përputhje me përcaktimet në këtë Udhëzim.
3. Njësitë bazë hartojnë grafikët përkatës dhe përcaktojnë datat dhe oraret e secilit provim me shkrim ose me gojë/në auditor ose online. Grafikët, në përbërje të të cilëve janë edhe komisionet për çdo lëndë/modul, miratohen dhe shpallen deri në datën 17 shkurt 2021.
4. Sekretaritetë mësimore ngarkojnë grafikët në sistem dhe vënë në dispozicion të pedagogëve listat paraprake të studentëve për çdo lëndë/modul. Pedagogët bëjnë kontrollin paraprak të listave të studentëve në momentin e fillimit të provimit dhe koordinojnë me sekretaritetë mësimore çdo paqartësi.

5. Pedagogët njoftojnë studentët në lidhje me vlerësimin e vazhduar si dhe vënë në dispozicion të tyre fondin e pyetjeve në përfundim të procesit mësimor.
6. Tezat e provimeve hartohen nga pedagogu/pedagogët e lëndës/modulit dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit sipas kuadrit ligjor në fuqi.

PROVIMET ONLINE

Provimet, të cilat zhvillohen online në Universitetin “Fan S. Noli”, duhet të realizohen sipas përcaktimeve të mëposhtme:

1. Provimet online kryhen sipas praktikave të vënë në dispozicion nga platforma Microsoft Teams 365 ose CleanScore. Manualët përkatëse të udhëzimit bashkëngjitur ose të aksesueshme në <https://www.youtube.com/watch?v=FUysh3XuVCs&t=9s>.

Stafi i Sektorit të Studimeve dhe TIK qëndron në dispozicion të çdo nevojë paraprake të shprehur nga pedagogët në lidhje me hartimin e tezës dhe procedurat e zhvillimit të provimit.

2. Provimet me shkrim realizohen në formën e quizeve në Platformat e sipërpërmendura.
 - a. Pedagogu bën hartimin e tezës dhe përcakton në platformë orarin, kohëzgjatjen e zhvillimit të provimit, vlerësimin dhe çdo element tjetër të rëndësishëm në procesin e provimit.
 - b. Si rregull, provimi me shkrim zgjat deri në 2 (dy) orë. Pedagogu përcakton gjithashtu nëse dorëzimi i tezave të plotësuara nga studentët pas përfundimit të orarit të përcaktuar merret parasysh ose jo.
 - c. Pedagogu bën korrigjimin dhe ngarkon në sistem rezultatet e vlerësimit sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren e organizimit të veprimitarisë mësimore dhe kërkimore në UNIKO.
 - d. Pedagogu arkivon dhe ruan materialin elektronik të tezave sipas përcaktimeve në Rregulloren e sipërpërmendur.
3. Provimet me gojë zhvillohen sipas grafikut në klasa që pedagogu i krijon në Microsoft Teams 365. Në klasat përkatëse bëhet pjesë edhe anëtar i komisionit të provimit dhe përgjegjësi i departamentit.
 - a. Provimet me gojë regjistrohen dhe formati i regjistruar ruhet nga pedagogu përkatës në rast ankimi nga ana e studentit.
 - b. Kohëzgjatja e provimeve me gojë llogaritet 15-20 minuta për student. Kurset që kanë më tepër se 20 studentë e zhvillojnë provimin në dy data të njëpasnjëshme duke përcaktuar qartë emrat e studentëve në secilën datë.
 - c. Pedagogu përcakton gjithashtu dhe vë në dispozicion të studentëve orën përkatëse të hyrjes në provim.

- d. Përzgjedhja e tezës bëhet nga studenti
- e. Pedagogu ngarkon rezultatet e provimit me gojë në sistem, sipas përcaktimeve në Rregulloren e organizimit të veprimitarisë mësimore dhe kërkimore në UNIKO.

PROVIMET NË AUDITOR

Provimet në auditor zhvillohen në përputhje të plotë me rregullat anti-Covid në fuqi.

- Kur numri i studentëve në grup është më i madh se 15 studentë, në grafik parashikohen më shumë se një auditor (me komisionet përkatëse), në të njëjtin orar, në dispozicion të provimit.
Njësia gjithashtu mund të vendosë që kur numri i kursit i tejkalon 15 studentë, provimi të zhvillohet në më shumë se një orar (me të njëjtin komision) në të njëjtin auditor. Në çdo rast organizimi dhe qëndrimi i studentëve në auditor bëhet në përputhje të plotë me rregullat anti-Covid në fuqi.
- Kohëzgjatja e provimit me shkrim nuk mund të jetë më shumë se 1 (një) orë.
- Kohëzgjatja e provimit me gojë nuk mund të jetë më shumë se 10-15 minuta për student.

Çdo element tjetër që lidhet me zhvillimet e provimeve në auditor realizohet në përputhje të plotë me përcaktimet në Rregulloren e organizimit të veprimitarisë mësimore dhe kërkimore në UNIKO.

RIPËRCAKTIMI I MASAVE ANTI-COVID

Aktiviteti arsimor është kategorizuar si aktivitet **me risk të lartë** në planin kombëtar të ri-hapjes së shoqërisë.

Objektivi i masave të përfshira në këtë udhëzim është të minimizojnë riskun për infektimin nga COVID-19, përmes praktikave të distancimit fizik dhe dezinfektimit.

Për të gjitha rastet kur është e domosdoshme të kryhet aktiviteti akademik me prani fizike të studentëve duhen zbatuar masat e mëposhtme:



Shmangia e rasteve të dyshuara

Studentët me shenja të sëmundjes

(<https://infocoronavirus2019.al/simptomat/>) këshillohen të qëndrojnë në shtëpi dhe të informojnë sekretarinë mësimore përmes telefonit. Sekretaria mësimore informon në dekanat për çdo rast të evidentuar.

Para hyrjes në godinën kryesore ku zhvillohet procesi i mësimdhënies, personi përgjegjës kryen për çdo individ:

- Verifikimin e temperaturës me termometër dixhital,
- Verifikimin e pajisjes me maskë



Distancimi fizik

Në mjediset e jashtme ruhet distanca mes studenteve dhe pedagogeve, duke vendosur shenja orientuese dhe duke afishuar informacion të dukshëm.

Në klasë/auditor ruhet distanca prej 1.5 metra mes studentëve. Nëse numri i studentëve është më i madh se sa hapësira e klasës që do të duhej për të respektuar këtë kusht, provimi zhvillohet në më shumë se një grup apo klasë sipas orarit të përcaktuar.

Departamentet, në bashkëpunim me Dekanatin dhe Sektorin e Shërbimeve organizojnë vendosjen e tavolinave dhe shenjave orientuese në përputhje me rregullin e cituar më lart mbi distancën fizike mes studenteve në mjedise të mbyllura.

Ruajtja e distancës fizike të cituar më sipër për mjediset e mbyllura, aplikohet edhe në çdo formë tjetër të komunikimit mes pedagogut dhe studentit, përfshi provimet.

Studentet në çdo hyrje në mjedisin e mbyllur ku do të zhvillohet provimi, verifikohen nga personi përgjegjës për temperaturën dhe pajisjen me maskë.

Orari i provimit duhet të sigurojë shmangjen e grumbullimit të më shumë se një grupi studentësh në mjedisin e mbyllur ku do të zhvillohet provimi.

Në çdo mjedis të mbyllur ku zhvillohet provime, afishohen masat e parashikuara në këtë rregullore.

Nuk lejohet asnjë aktivitet tjetër arsimor veç atyre më të domosdoshëm, të përcaktuar në këtë udhëzim.



Mbajtja e maskave

Në klasë/auditor dhe në të gjithë mjediset e mbyllura studentët dhe personeli, mbajnë maska.

Në hyrjen e çdo mjedisi të mbyllur afishohet një kujtesë lidhur me mbajtjen e maskave



Dezinfektimi dhe higjena

Personeli dhe studentet dezinfektojnë duart gjatë hyrjes/daljes në/nga klasë/auditor duke përdorur kontenierët e vendosur për këtë qëllim në katin përkatës.

Sipërfaqet e tavolinave në auditore dezinfektohen pas çdo aktiviteti arsimor duke përdorur pajisjet e vendosura në auditorë për këtë qëllim.

Sigurohet ajrosja e vazhdueshme e klasave apo auditoreve, para, gjatë dhe pas provimit.

Në hyrjen e klasës afishohet një kujtesë mbi dezinfektimin e duarve dhe të sipërfaqeve të tavolinave

Korridoret e mjediseve ku zhvillohet aktiviteti arsimor pastrohen/dezinfektohen çdo dy orë. Tualetet pastrohen/dezinfektohen çdo 30 minuta. Dorezat, parmakët dhe sipërfaqe të tjera në mjediset pranë sallës/auditorit ku zhvillohet aktiviteti arsimor, pastrohen/dezinfektohen çdo 30 minuta.

REKTORI
Prof. dr. Dhimitri Bello

